



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2024:068392  
Datë: 10.06.2024  
Numri i dokumentit: 05799994

P.nr.2024:068392

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal**, me gjyqtarin e vetëm gjykues Lulzim Paçarizi, si dhe sekretaren juridike Behije Karaçica, në çështjen penale ndaj të akuzuarit D.V për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par.8 lidhur me par.6 dhe 1 të KPRK-së, ndërsa sipas aktakuzës PP.nr.1892/2022 të dt.26.04.2024, pas mbajtjes të shqyrtimit fillestar, të dt.05.06.2024, ku prezent ishin Prokuroria e shtetit Uridia Caka, i akuzuari D.V me mbrojtësin e tij av.A.I me autorizim dhe i dëmtuari F.S, me dt.07.06.2024, shpallë, ndërsa me dt.09.06.2024, e përpilon këtë:

## A K T G J Y K I M

**I AKUZUARI: D.V**, nga i ati D dhe e ëma N e lindjes B, i lindur më datën ...., në Prishtinë, ku edhe banon në, me nr.personal:..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, i ati i 1 fëmije, ka të kryer shkollën fakultetin, punëtor, i gjendjes së mesme ekonomike.

## Ë S H T Ë F A J T O R

Për shkak se me dt.02.12.2022, rreth orës 09:20 në rrugën rajonale Klinë - Gjakovë, me të arritur afër fsh.Kramovik, afër betonierës "C", duke vepruar nga pakujdesia dhe në kundërshtim me nenin 53 të Ligjit nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor, shkakton aksident trafiku dhe me këtë rrezikon jetën e njerëzve, në atë mënyrë që i pandehuri gjersa ishte duke drejtuar automjetin e tipit S, me targa ..., duke mos pasur kujdes të shtuar duke mos ia përshtatur shpejtësinë kushteve dhe rrethanave të rrugës, i njëjti gjatë drejtimit të automjetit në rrugën regjionale Klinë - Gjakovë me të arritura afër betonierës "C", deri sa ishte në drejtimin e tij qarkullues ndërmerr veprimin e tejkalimit të automjetit O me targa .... të cilën e drejtonte I.M, pa u bindur mirë se shiriti i komunikacionit në të cilin do të bëjë tejkalimin është i lirë, ku kalon nga shiriti i djathtë i lëvizjes në shiritin e majtë, e në ato momente nga drejtimi i kundërt i lëvizjes së tij Gjakovë-Klinë ishte duke lëvizur automjeti M me targa ....., të cilin e drejtonte L.K, ashtu që për shkak të distancës së vogël automjetet përplasen frontalisht bashkë, dhe si pasojë e

inercionit i pandehuri me automjetin e tij sillet rreth boshtit të tij e më pas e godet automjetin O me targa .... i cili ishte duke lëvizur në shiritin e tij qarkullues drejtimi Klinë -Gjakovë me ç' rast si rezultat i aksidentit shkaktohen dëme materiale në të 3 veturat, si dhe lëndime të rënda trupore pëson pasagjeri i veturës S i dëmtuari F.S dhe atë thyerje e filgjanit të kërdhokullës së djathtë si dhe të dëmtuarit tjerë F.K, L.K, L.K, M.K si dhe Gj.S pasojnë lëndime të lehta trupore , të përshkruara më gjerësisht sipas ekspertizës mjeko ligjore të Dr. B.C, dt.26.04.2023.

- Me këto Me këto veprime ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 370 par.8 lidhur me par.6 e lidhur me par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata konform nenit 4, 17, 39, 40, 42, 43, 44, 46, 69, e nenit 370 par.8 lidhur me par.6 e lidhur me par.1 të KPRK-së si dhe nenit 364, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës të njëjtin e :

## G J Y K O N

Me dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, me kërkesën dhe pëlqimin e mbrojtësit të te akuzuarit, av. A.I dhe të akuzuari D.V dënimi me burgim i zëvendësohet me dënimin me gjobë.

Në bazë të nenit 44 par.2 të KPRK-së, gjykata të njëjtit ia shqipton :

**DËNIMIN ME GJOBË** në shume prej **dymijë euro (2000 €)** , të cilën shumë është i obliguar që ta paguaj në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Poqe së dënimi me gjobë nuk mund të realizohet konform nenit 43 par. 3 të KPRK-së, i njëjti do t`i zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej njëqind ditësh (100), duke llogaritur çdo ditë burgu me nga 20 €.

Obligohet i akuzuarit në emër të paushallit gjyqësor gjykatës t`ia paguajnë shumen prej tridhjetë euro (30 €), për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej njëzet euro (20 €), ndërsa në emër të shpenzimeve të procedurës penale shumë prej njëqind euro (100) , të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën ekzekutimi do të bëhet me detyrim.

Te dëmtuarit F.S, F.K, L.K, L.K, M.K si dhe Gj.S, lidhur me kërkesën pasuare juridike udhëzohet në kontestin civil.

## A r s y e t i m

### 1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP.nr.1892/2022 të dt. 26.04.2024, e ka akuzuar D.V, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par.8 lidhur me par.6 dhe 1 të KPRK-së, duke i propozuar gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor si dhe administrimit të provave, të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoj në bazë të ligjit.

Gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me dt.05.06.2024, ku prezent kanë qenë, prokuroria e shtetit Uridia Caka, i akuzuari D.V me mbrojtësin e tij av.A.I dhe i dëmtuari F.S, andaj ka pasur kushte për mbajtjen e shqyrtimit fillestar.

I akuzuari D.V, pas konsultimit paraprak me mbrojtësin e tij deklarohet i fajshëm për veprën penale për të cilën ngarkohet, duke shtuar se që në fillim e kam pranuar fajësinë, më vije keq për rastin i cili ka ndodhur, natyrisht që aksidentin nuk e kam bërë me dashje por nga pakujdesia.

Mbrojtësi i të akuzuarit av.A.I ka deklaruar: : Si mbrojtës i të pandehurit pas konsultimeve të mjaftueshëm me të mbrojturin tim unë pajtohem me pranimin e fajësisë i cili u bë në mënyrë vullnetare pa presion, po ashtu duke ja shpjeguar efektet dhe benefitet e pranimit të fajësisë, andaj kërkojmë nga gjykata që të aprovon pranimin e fajësisë, po ashtu kërkojmë nga gjykata me rastin e matjes dhe caktimin e dënimit ti merre parasysh rrethanat lehtësuese siç është pranimi i fajit qysh në fillim të procedurës në polici dhe prokurori, kërkim faljen, pendimin, i mbrojturi im ka qenë korrekt dhe bashkëpunues me institucionet e drejtësisë, po ashtu i mbrojturi im ka pasur komunikim që në fillim me të dëmtuarin dhe sot mban ende raporte miqësore, është hera e parë që bije ndesh me ligjin, është mbajtës i familjes, është student, i njëjti për ta mbajtur familjen është i angazhuar me një kompani private ku merre një pagë, po ashtu i propozojmë gjykatës dhe japim pëlqimin që në rast të shqiptimit të dënimit me burg të zëvendësohet me dënim me gjobë konform nenit 44 të KPRK-së duke marrur parasysh pasiqë i mbrojturi im është duke punuar me një kompani private e me qëllim që të mos shkaktohen pasoje juridike.

I akuzuari D.V pajtohet dhe jep pëlqimin ashtu siç propozojë mbrojtësi i tij që në rast të shqiptimit të dënimit me burg ti zëvendësohet me dënim me gjobë.

I dëmtuari F.S ka deklaruar: Se nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë, nuk i bashkangjitem ndjekjes penale dhe parashtoj kërkesë pasurore juridike ndaj kompanisë së sigurimeve përkatëse, po ashtu deklaroj se me të akuzuarin kemi raporte të mira, dhe me rastin e aksidentit është përkujdesur po ashtu edhe pastaj gjithnjë është përkujdesur për mu dhe për të dëmtuarit tjerë.

Prokuroria e shtetit Uridia Caka në shqyrtimin fillestar ka deklaruar: Nuk e kundërshton pranimin e fajësisë të bërë nga i akuzuari meqenëse i njëjti e ka bërë në mënyrë vullnetare pas konsultimeve me mbrojtësin e tij, dhe se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes, provat materiale dhe personale me të cilat është ngritur kjo aktakuzë andaj i propozojë gjykatës që ta pranojë pranimin e fajësisë, të njëjtin ta shpallë fajtorë dhe ta dënoj sipas ligjit, dhe po ashtu me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë të dënimit si rrethanë lehtësuese të merre pranimin e fajësisë ndërsa si rrethanë renduese të merre faktin se ka disa të dëmtuar dhe se të merre parasysh rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

## 2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 242 të KPPRK-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoj se i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

## 3. Gjendja faktike e vërtetuar.

Duke u bazuar në këto që u ceken me lart gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

-se i akuzuari D.V nga pakujdesia ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par.8 lidhur me par.6 dhe 1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjendjen e këtillë faktike e mori në tërësi ashtu siç ishte përcaktuar në aktakuzë dhe në provat të cilat i përmbante aktakuza, e ato janë:

- Raport i hetuesit mbi vend shikimin e aksidentit, dt.02.12.2022;
- Deklaratën e të pandehurit D.V, të dhënë në polici me datë 03.12.2022 dhe prokurori më datë 23.04.2024;
- Deklaratën e të dëmtuarit L.K, e dhënë në polici me datë 02.12.2022;
- Deklaratën e të dëmtuarit I.M, e dhënë në polici me datë 02.12.2022;
- Akt Ekspertimi Mjeko – Ligjor nga Dr. B.C, të datës 26.04.2023;
- Ekspertiza e aksidentit të trafikut rrugor, nga eksperti i komunikacionit E.T, e punuar më datë 13.11.2023;
- Foto dokumentacioni, si dhe shkresat tjera në lëndë.

## 4. Elementet e veprës penale.

Në nenin 370 par.8 lidhur me par.6 dhe 1 të KPRK-së, është parashikuar se: *Nëse vepra penale nga paragrafi 6. i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor ose dëm pasuror në vlerë prej njëzetmijë (20.000) Euro apo më shumë, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet lidhur me Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit dhe Kushdo që shkel ligjin mbi trafikun publik apo transportin rrugor dhe rrezikon jetën e njerëzve apo pasurinë dhe me këtë i shkakton dikujt dëm të konsiderueshëm pasuror, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.*

#### 5 Vendimi i gjyqtarit të vetëm gjykues.

Duke u bazuar në këto që u ceken me lart gjyqtari i vetëm gjykues të akuzuarin D.V e ka shpallur fajtor për veprën penale për të cilën ngarkohet, nga se në veprimet e tij të përshkruara si në dispozitiv të aktgjykimit, formohen të gjitha elementet e veprës penale rrezikimi i trafikut publik sipas nenit 370 par.8 lidhur me par.6 dhe 1 të KPRK-së, për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta gjykoj në bazë të ligjit, e me parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

#### 6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit.

Gjykata me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit ka vlerësuar që të akuzuarit duhet ti shqiptohet dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, sjelljen dhe rrethanat e kryesit si dhe përgjegjësinë penale të tij, gjykata me rastin e matjes së dënimit pati parasysh rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit si në kuptim të nenit 69 të KPRK-ës ashtu që gjykata me rastin e caktimit të dënimit pati parasysh rrethanat lehtësuese si pranimin e fajit nga ana e të akuzuarit, për herë të parë ka ra ndesh me ligjin, është mbajtës i familjes prej 6 anëtarësh, jeton në shtëpi të prindit, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej kurrfarë vepre penale, ndërsa si rrethanë rënduese faktin se ka disa të dëmtuar, andaj gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin me gjobë në shume prej **dymijë euro (2000 €)**, mund të arrihen qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës të cilat konsistojnë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

#### 7. Vendimi mbi udhëzimin në kontestin civil

Vendimi mbi udhëzimin në kontestin civil është marr konform nenit 462 par. 1 dhe 2 të KPPK-së.

#### 8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale.

Vendimi paushallin gjyqësor dhe shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 449 par.1 dhe 2 të KPPK-së, ndërsa vendimi në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marr konform nenit 39 parg.3 nënparagrafi 3.1 të Ligjit nr.05/L036 për kompensimin e viktimave të krimit.

Me sa u tha me lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e konform nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA RAHOVEC**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal**  
**P.nr.2024:068392, me dt.07.06.2024.**

Sekretarja juridike  
Behije Karaçica

Gjyqtari i vetëm gjykues  
Lulzim Paçarizi

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, nëpërmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.